

## PAJISJET PËR TRAJTIMIN E MBETJEVE VOLUMINOZE

Për mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve voluminoze nevojiten pajisjet e mëposhtme:

1. Bluajtësi i mbetjeve;
2. Kamioni për zhvendosjen e bluajtësit (në rastin e përdorimit të një bluajtësi të fiksuar);
3. Kamioni transportues;
4. Kazanë 1.100 litra për depozitim të materialit të bluajtur.

### Bluajtësi i mbetjeve

Një bluajtës i lëvizshëm është një makineri e prodhuar për të reduktuar përmasat e copave në mënyrë të shpejtë dhe eficiente të një grupi të madh materialesh të ndryshëm që shkojnë nga mbetjet e ngurta urbane tek ato industriale.

Veçoria e një pajisjeje të tillë qëndron në praninë e një sistemi lëvizës i cili e lejon bluajtësin të vendoset në afërsi të mbetjeve që do të trajtohen, në mënyrë që të bëjë të mundur një ngarkesë maksimale dhe reduktimin sa më shumë të jetë e mundur, e kohës së proceseve të punës. Bluajtësi mund të projektohet në mënyrë të tillë që të spostohet vetë në mënyrë autonome, me anën e zinxhirëve, ose të ngarkohet me lehtësi në një kamion të veçantë i pajisur me ganxhë ose vinç, i cili bën të mundur spostimin e pajisjes deri në pikën më të favorshme për ngarkesën. Të dyja zgjidhjet lejojnë një spostim optimal të bluajtësit, dhe preferenca për njërin apo tjetrën varet kryesisht nga hapësirat në dispozicion dhe nga sasia dhe tipologjia e mbetjeve që do të trajtohen.

Një bluajtës i lëvizshëm mund të përdoret me sukses në shumë konteste të ndryshëm të cilët shkojnë nga ndërmarrjet e veçanta prodhuese të mbetjeve deri në **ishujt ekologjikë** (rasti i Bashkisë Himarë) dhe qendrat për trajtimin e mbetjeve, dhe përdorimi i tij garanton gjithmonë avantazhe të mëdha përsa u përket aspekteve logjistike, organizative dhe performancës.

Gjithashtu, një bluajtës i lëvizshëm rezulton një ndihmesë e madhe për trajtimin e **mbetjeve voluminoze** dhe me karakteristika të veçanta, siç është rasti për shembull, i pajisjeve shtëpiake.

Bluajtësit e lëvizshëm mund të jenë të pajisur me dy tipologji strukture: lëvizje me ngarkim në mjet dhe vetëlëvizës me zinxhirë.

Në rastin e një strukture të lëvizshme me mjet, bluajtësi është i ndërtuar në mënyrë të tillë që të mund të zhvendoset me lehtësi mbi një kamion të pajisur me ganxhë të posaçme ose vinç, dhe që mund të lëvizë lirisht në brendësi të zonës së punës duke e spostuar bluajtësin në pikën më të favorshme. Pas vendosjes në pozicionin e duhur, bluajtësi mund të shkarkohet lehtësisht nga kamioni dhe të fillojë funksionimin, dhe më pas mund të spostohet përsëri sipas rastit. Në këtë mënyrë, zënia e sipërfaqes rezulton minimale dhe maksimizohet eficientia e funksionimit, duke reduktuar kohën e ngarkimit të bluajtësit dhe duke lehtësuar operacionet e kryera nga operatorët, sidomos në **rastin e trajtimit të mbetjeve voluminoze**.

Ndërsa një bluajtës i lëvizshëm me zinxhirë është tërësisht vetëlëvizës, dhe nuk ka nevojë të instalohet mbi suporte të veçantë për t'u spostuar në brendësi të zonës operative. Prania e zinxhirëve e lejon makinerinë të zhvendoset në mënyrë krejtësisht autonome në brendësi të impiantit, pa qenë nevoja të vendoset mbi kamion ose automjet të pajisur me ganxhë.

Është e rëndësishme të theksohet që sistemet e lëvizjes nuk ndikojnë fare mbi performancën e bluajtësve, të cilët janë të pajisur me lama dhe rotorë identikë me ata të bluajtësve të fiksuar. Aftësia prerëse, polivalenca dhe efiçenca mbeten gjithmonë të njëjtat si ato të një bluajtësi të fiksuar, por këtyre veçorive u shtohen edhe avantazhe të tjerë të shumtë nga pikëpamja organizative dhe logjistike.




**Fig 1. Bluajtës  
vetëlëvizës me  
zinxhirë**



**Fig. 2. Bluajtës i fiksuar**

Pajisjet për trajtimin e mbetjeve voluminoze

---



**Fig 3. Tipe të ndryshëm të pajisjes prerëse me lama**



**Fig 4. Kamion për spostimin e bluajtësit**



**Fig. 5. Kamion për transportin e mbetjeve voluminoze**

Pajisjet për trajtimin e mbetjeve voluminoze

---



**Fig. 6. Sistemimi i mbetjeve voluminoze përpara banesës**



**Fig. 7. Kontejner 1.100 litra për depozitimin e materialit të bluajtur**

**Preventivi paraprak**

Pajisjet për trajtimin e mbetjeve voluminoze

---

<b>Nr.</b>	<b>Pajisja/Mjeti</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi (€)</b>	<b>Vlera (€)</b>
1.	Bluajtës vetëlëvizës me zinxhirë	1	150.000	150.000
2.	Kamion i hapur 3.5 t	1	40.000	40.000
3.	Kontejner për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve, kapaciteti 1.100, i çertifikuar UNI EN 840, kapëse mashkull DIN 30700, kapak i rrotullueshëm, ngjyra e gjelbër	3	450	1.350
<b>Totali</b>				<b>201.350</b>